



**AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"B-2"**

Në këtë Statut termat vijues kanë këtë kuptim:

- "Ligji": është Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar);
- "Statuti": është statuti i shoqërisë;
- "Ditë të Plota": në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

Neni 1

Data e Themelimit, Emri, Themeluesi dhe Administratori

- 1.1 Në datë 25.05.2020, unë themelusi, kam krijuar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "B-2" sh.p.k.
- 1.2 Ortaku i vetëm i shoqërisë "B-2" sh.p.k, është: z. Bujar Hasaj, atësia Kovaç, lindur në Peshtan i Madh, Fier më 15.02.1961 dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin me Nr. 033768902 Personal Nr. G10215236F.
- 1.3 Administratori i parë i shoqërisë do të jetë z. Bujar Hasaj, atësia Kovaç, lindur në Peshtan i Madh, Fier më 15.02.1961 dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin me Nr. 033768902 Personal Nr. G10215236F.
- 1.4 Afati i emërimit të administratorit është nga data 25.05.2020 – 25.05.2025.

Neni 2

Objekti

- 1.5 Shoqëria do të kryejë aktivitetin:
"Mbështetja e shoqërive të kontrolluara nëpërmjet ndihmës, menaxhimit, zhvillimit të teknikave dhe teknologjive të ndërtimit. Kjo mbështetje do të ofrohet në aktivitetin tregtar të shoqërive në të cilat "B-2" sh.p.k zotëron mbi 50% të kapitalit."
- 2.1 Objekti i aktivitet mund të shtohet, pakësohet dhe ndryshohet kurdoherë me vendimin e Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 4

Selia, Adresa dhe të dhëna të tjera kontakti

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: *Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga "Artan Lenja", Kompleksi i ndërtimeve "IBN" shpk, Godina 4, Ap. 5*
- 4.2 Emri tregtar i shoqërisë do të jetë: "Menaxhim – Teknikë – Teknologji"
- 4.3 Adresa e e-maili-it të shoqërisë është: bujarhasaj@gmail.com
- 4.4 Numri i kontaktit të shoqërisë është: 00355 68 605 0500

KREU II

KAPITALI DHE KUOTAT

Neni 5

Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000,000 (një milion) Lekë.
- 5.2 Kapitali përbëhet nga një kuotë të vetme.
- 5.3 Ortaku i vetëm e zotëron kuotën të plotë.
- 5.4 I gjithë kontributi për formimin e kapitalit themeltar të shoqërisë përbëhet në para.

Neni 6

Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara

- 6.1 Administratorët mund t'u kërkojnë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.
- 6.2 Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.
- 6.3 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaj një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.
- 6.4 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratorët mund të njoftojnë paraprakisht të paktën katërmëdhjetë Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumën e mundëshme shtesë të kamatvonesës. Njoftimi do të përmbajë

vendin ku do të kryet pagesa dhe deklarimin se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.

- 6.5 Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorëve dhe anulimi do të përfshijë të gjitha dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.
- 6.6 Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratorët konsiderojnë të përshtatshme.
- 6.7 Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuota por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyeshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

Neni 7

Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

- 4.1 Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa çenuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emërtohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve, në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

Neni 8


Certifikatat e kuotave

- 8.1 Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij.
- 8.2 Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkarisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesëve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit.
- 8.3 Emrat e zotëruesëve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës.
- 8.4 Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 9

Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave

- 9.1 Kuotat e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - 9.1.1 Kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
 - 9.1.2 Shit-blerjes;
 - 9.1.3 Trashëgimisë;
 - 9.1.4 Dhurimit



9.1.5 Çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj;

9.2 Pjesët e kapitali themeltar janë lirisht të transferueshme nëpërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në Statut.

Neni 10

Kalimi me Kontratë i Kuotave

10.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratorët. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.

10.2 Administratorët mund të refuzojnë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKB në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratorët nuk janë dakord me personin të cilit i kalon kuota.

10.3 Nëse Administratorët refuzojnë të regjistrojnë kalimin e kuotës, ata do të njoftojnë për mospranimin personin të cilit i kalohet kuota, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

Neni 11

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

11.1 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e trashëgimisë ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë nga ortakët e tjerë ta blenë atë kuotë, para se t'ia ofroj për shitje personave të tretë.

11.2 Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithëshme, deri në momentin e regjistrimit të kuotës në QKB.


Neni 12

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

12.1 Asambleja e Përgjithëshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithëshme me shumicën e kualifikur të votave të ortakëve.

12.2 Nëse një (ose më shumë) nga ortakët nuk mund të kontribuojnë në zmadhimin e kapitalit, atëherë kjo nuk përbën pengesë për Asamblesën e Përgjithëshme ta zmadhojë kapitalin sipas pikës (12.1) më sipër, duke rritur kuotat e ortakëve të tjerë dhe duke ndryshuar raportet lidhur me pjesën takuese të secilit ortak.

12.3 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithëshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.



Neni 13

Blerja e Kuotave të Veta

- 13.1 Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja, vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratorët lëshojnë një certifikat të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen.
- 13.2 Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit.

Neni 14

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 14.1 Asambleja e Përgjithëshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithëshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
- 14.2 Shoqëria mund të vendos zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithëshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek oratakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.


KREU III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 15

Organi Vendimmarrës

- 15.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 15.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit sipas mënyrave të përcaktuara në ligj.
- 15.3 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtëme:
- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - Ndryshimet e Statutit;
 - Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve
 - Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat c) dhe d) të kësaj pike;
 - Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;




- h) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - j) Riorganizmin dhe prishjen e shoqërisë;
 - k) Miratimin e rregullve procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
 - l) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji, Statuti, apo çështje të tjera të paparashikuara por që për t'u marrë vendim për to lind nevoja gjatë ushtrimit të aktivitetit;
- 15.4 Asambleja e Përgjithshme "anulon" dhe/ose "shfuqizon" vendimet (apo akte të tjera) e administratorëve, kur ato janë në dëm të interesave të shoqërisë. Anulimi ka pasoja për të shkuarën, ku administratori përgjigjet dhe zhdëmton pasojat e krijuara, ndërsa shfuqizimi ka pasoja vetëm për të ardhmen.
- 15.5 Ortaku nuk mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një prson i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite, sipas neneve të këtij Statuti.
- 15.6 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. Çdo veprim përfaqësimi në kundërshtim me këtë përcaktim, passjell pavlefshmëri absolute të mbledhjes dhe akteve të nxjerra prej saj.

Neni 16

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme


- 16.1 Administratorët thërrasin Asamblenë e Përgjithshme me kërkesën e ortakëve sipas nenit 84 të Ligjit.
- 16.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*e-mail*) apo postë të zakonshme, drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga shumica e ortakëve të cilit zotërojnë jo më pak se nëntëdhjetë për qind të vlerës nominale të kuotave.
- 16.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme të njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.
- 16.4 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikave të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.



Neni 17

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe Kuorumi

- 17.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuoromit. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 (tridhjetë) përqind të kuotave. Kur Asambleja duhet të vendos për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit.
- 17.2 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 17.3 Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjetet komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar ë bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- 17.4 Kur Asambleja duhet të vendos për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit.
- 17.5 Administratorët caktojnë Kryetarin e mbledhjes si dhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
- 17.6 Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- 17.7 Administratori, pavarisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
- 17.8 Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por, në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.



- 17.9 Asambleja vendos me votim të hapur, me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga: Kryetari; ose një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vet ortakut.
- 17.10 Me përjashtim të kundërshtimit të një ortakut, deklarimi i Kryetarit së vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me shumicë të caktuar, nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në proceverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara "pro" ose "kundër" vendimit.
- 17.11 Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 18

Votat e Ortakëve

- 18.1 Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- 18.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.
- 18.3 Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do t'i komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 19


Votimi me Prokurë

- 19.1 Përfaqësuesi do të emërtohet nga ortakut sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratorët):

"... SH.P.K ...

Unë i/të nënshkruari/t, ... në cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më ... ose në pamundësin e tij, ... në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emrin tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më ... dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Nënshkruar më ..."



19.2 Në rastet kur dëshirohet t'u jepet ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën e veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtëme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratorët):

"... SH.P.K ...

Unë i/të nënshkruar/i/t, ... në cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më ... ose në pamundësinë e tij, ... në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emrin tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më ... dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Kjo formë do të përdoret për vendimet e përmendura më poshtë:

*Vendimi Nr. 1 *pro *kundër.*

*Vendimi Nr. 2 *pro *kundër.*

Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme.

Nënshkruar më ..."

19.3 Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria

19.4 Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administrata depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

19.5 Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*e-mail*) sipas përcaktimeve të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.


Neni 20

Marrja e vendimeve

20.1 Asambleja e Përgjithshme vendos e tri të katërtat e votave të zotëruesëve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për:

- a) ndryshimin e Statutit;
- b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
- c) shpërndarjen e fitimeve;
- d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

20.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:



- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- c) përcaktimin e shpërblimeve
- d) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- e) miratimin e rregullve procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- f) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- g) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

Neni 21

Përfshirja nga drejta e votës

Ortaku, nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngrkim të tij;
- c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) Dhënieve ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku të cilin përfaqëson.

KREU IV ADMINISTRATORËT

Neni 22


Emërimi i Administratorëve

- 22.1 Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit.
- 22.2 Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë nga Asambleja e Përgjithshme i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 22.3 Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të ligjit, ku administratorët e një shoqërie mëmë nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.


Neni 23

Kompetencat e Administratorëve

- 23.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:




- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë së shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
 - d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) Kryejnë regjistrimet dhe dëgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për QKR/QKB;
 - g) Raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut;
- 23.2 Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:
- 23.2.1 Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
 - 23.2.2 Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 23.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një Administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.
- 23.4 Politikat tregëtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 81 të ligjit. Ndryshimet e Statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqëzojnë aktet e mëparshme të Administratorëve, të cilët do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.
- 23.5 Administratorët mund të marrin direktiva/orientime/rekomandime nga Asambleja, se cili mund të jetë personi ku ata mund të delegojnë kompetencat e tyre përkohësisht. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosin Administratorët dhe mund të revokohet ose ndryshohet prej tyre. Me delegimin e kompetencave, Administratorët nuk delegojnë asnjëherë detyrimet e tyre ligjore, sepse veprohet sipas parimit: *"Delegohen kompetencat, jo përgjegjësitë"*



Neni 24

Përgjegjësitë e Administratorit

- 24.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 24.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 24.3 Për sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17, dhe 18 të ligjit, administrator detyrohet:
- 24.3.1 Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në Statut në mirëbesim e në interesin më të lartë / më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis:
- 24.3.2 të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- 24.3.3 të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- 24.3.4 të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, present apo të mundshëm, të interesave personal me ata të shoqërisë;
- 24.3.5 të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 24.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 24.5 Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave më sipër, është i detyruar që kurdoherë (pa efekte parashkrimi) t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.
- 24.6 Administrator ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 24.7 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit kryen veprimet e mëposhtme:
- a) U kthen ortakëve kontributet;
 - b) U paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) U shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;



- e) Jep kredi;
- 24.8 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngrkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të bëjnë kallëzim penal kundër administratorit.
- 24.9 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i Asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër Administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.
- 24.10 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë sipas Statutit.

Neni 25

Shkarkimi i Administratorëve

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
- personi ndodhet në gjëndje paaftësie paguese;
- personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullimet mendore;
- personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
- ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Administratorëve, vendos ta shkarkojë nga detyra.


Neni 26

Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorëve

- 26.1 Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.
- 26.2 Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person ia cili ka qënë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qënë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre dhe mund të paguajnë kontribute në fonde të caktuara për dhënie të përfitimëve të tilla.
- 26.3 Administratorëve mund t'iu paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Administratorëve ose të komiteteve të Administratorëve ose të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

Neni 27

Mbledhjet e Administratorëve




- 27.1 Mbledhjet e Administratorëve do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.
- 27.2 Vendimet e mbledhjes së Administratorëve merren me kuorumin e votave që mund të përcaktohet nga Administratorët dhe në rast se ky kuorum nuk është përcaktuar ai do të jetë dy.
- 27.3 Asambleja e Përgjithshme cakton njërin prej Administratorëve me detyrën e Kryetarit të mbledhjes së Administratorëve, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo mbledhje të Administratorëve në të cilat ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga ora e caktuar për mbledhjen, Administratorët e pranishëm mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- 27.4 Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
- 27.5 Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorëve, ose nga një komitet i Administratorëve, apo nga persona që veprojnë si Administratorë, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e një Administratori, ose njëri prej tyre ka qënë i skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëjloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe do të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si Administratorë dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.
- 27.6 Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë Administratorët që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Administratorëve ose nga komiteti i Administratorëve do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëjloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Administratorëve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

Neni 28

Kufizimet në Votim të Administratorëve

- 28.1 Administratorët nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Administratorëve për çështje në të cilin këta antarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim, i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:
- 28.1.1 të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe
- 28.1.2 të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.
- Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qëndres Kombëtare të Regjistrimit.
- 28.2 Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë. Dispozitat e nenit 89 të Ligjit do të zbatohen lidhur me përjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra në këtë mbledhje.
- 28.3 Në rast se në mbledhjen e Administratorëve ose komitetit të Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një Administratori, çështja mund t'i drejtohet Kryetarit të



mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vet do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

Neni 29

Procesverbalet e Mbledhjeve të Administratorëve

29.1 Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

- të gjitha takimeve të kryera nga Administratorët;
- të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme,
- mbledhjeve të Administratorëve dhe komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

KREU V

DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KPITALIN THEMELTAR

Neni 30


Dividendët

- 30.1 Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 30.2 Me përjashtim të rastëve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguara për kuotat, për të cilën paguhet dividend. Të gjithë dividendët pjestohen dhe paguhet në përpjestim të drejtë me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të përiudhës për të cilën paguhet dividend: në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- 30.3 Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
- 30.4 Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që të paguajë atë.

Neni 31

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

- 31.1 Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të cilësuar, duke pasur parasysh parimin e nenit 14 të Ligjit, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e shoqërisë.



KREU VI VITI FINANCIAR – EKSPERTËT

Neni 32 Viti financiar

- 32.1 Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.
- 32.2 Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.


Neni 33 Ekspertët

- 33.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 33.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU VII PRISHJA APO RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 34 Prishja e shoqërisë dhe likuidimi

- 34.1 Shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) Me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
 - c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë së përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit për QKR;
 - e) Me vendim të gjykatës;
- Në këtë rast, ortakët marrin vendim me shkrim, në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "shoqëri në likuidim e sipër".
- 34.2 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.



- 24.3 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesëve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.
- 24.4 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

Neni 35

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi – ndarja

- 35.1 Shoqëria mund të ndahet dhe ose bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit.

Neni 36


Dispozita të fundit

- 36.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e këtij Statuti.
- 36.2 Për çdo situatë të pa shkruar shprehimisht në Statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në, Kodin Civil, çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive aksionare, si dhe çdo ligj specifik në Republikën e Shqipërisë.

Tiranë, më 25.05.2020

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË "B-2" SH.P.K
ORTAK I VETËM**

BUAJR HASAJ



(Emë, Mbledhri dhe nënshkrimi)

